



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr.419, datë 30.07.2024

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT ZNJ. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.233, DATË 02.05.2024, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 30.07.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre kritereve ligjore të kandidimit për lëvizjen paralele, të kandidatit znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati znj. {...}, në procedurat për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 233, datë 02.05.2024, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.233- nr.243, datë 02.05.2024 dhe nr.260, datë 16.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/Durrës/Tiranë dhe

Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, penale dhe administrative.

2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit ishte data 16.05.2024 dhe data 30.05.2024.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë nr.233 datë 02.05.2024 kandidoi edhe znj. {...} gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

4. Mbas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 233/2024, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 297, datë 05.06.2024, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim etike dhe profesionale (shtojca nr. III) për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe znj. {...}.

4. Me Vendimin nr. 298, datë 05.06.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/ Durrës/Tiranë/ dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë tiranë, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”, Këshilli ka vendosur:

“5.Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan të shpallur me vendimin nr. 233, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim..

6. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro; ...”.

5. Më datë 07.06.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si vendimi 320/2020), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: i) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; ii) për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; iii) për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

6. Brenda afatit të përcaktuar, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 55, Seksioni C, Kreu V, të vendimit 320/2020, përmes shkresave të veçanta, për kandidatin znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykata ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

8. Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale specifike” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me anë të postës elektronike të datë 07.06.2024, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

9. Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale specifike” të kandidatit në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, informacioni u kërkua në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, informacioni i kërkuar është përcjell nëpërmjet postes elektronike siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT

10. Për kandidatin znj. {...} u verifikua kriteri i “Përvojës profesionale specifike minimale”

11. “Përvoja profesionale specifike minimale” për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, në rastin konkret në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të vendimin nr. 233/2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*.

12. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për lëvizjen paralele u mbajt parasysh se ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 233/2024, çka do të thotë se kandidati duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit.

13. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati, evidentohet se znj. {...} ka përfunduar studimet degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 19.07.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në “E drejtë Penale” në Universitetin e Tiranë në vitin 2014 si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2022. Me vendim nr. 312, datë

20.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar si dhe me vendim nr. 334, datë 22.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë *Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*, tani Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

14. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 19.07.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë Penale” në Universitetin e Tiranë në vitin 2014 si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2022. Me vendim nr. 312, datë 20.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar. Me vendim nr. 334, datë 22.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me vendim nr. 141, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 1 vit. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

15. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nga verifikimet e kryera, rezulton se: “1- Me vendimin nr. 8705 Prot, datë 14.09.2022 ka qenë gjyqtare e gjykimit të çështjeve të përgjithshme (gjykimin e çështjeve penale & civile) 2- Me Vendimin e Këshillit të Gjykatës nr. 104 Prot, datë 14.11.2023, dhe në vijim është gjyqtare e seksionit të përgjithshëm e cila gjykon të gjitha çështjet përveç atyre që gjykon seksioni i të miturve.”

16. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 233, datë 02.05.2024, ka mbi një vit përvojë profesionale specifike minimale si gjyqtar në fushën e së drejtës civile gjatë pesë viteve të fundit përpara kandidimit, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

17. Për kandidatin znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

18. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “b”, të pikës 5, të vendimit nr. 233/2024, është parashikuar në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë nëse ka në fuqi një masë disiplinore.”

19. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 16.06.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masa disiplinore në fuqi”.

20. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

21. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

22. Për kandidatin znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

23. “Papajtueshmëria ambientale” si kriter ndalues për lëvizjen paralele të gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimin nr. 233/2024, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... transferimit, ..., për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproportionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efiçenca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me lëvizjen paralele, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.*

24. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 16.06.2024, nëpërmjet të cilit, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

25. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa kandidon për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

26. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, për kandidatin Këshilli vlerëson se znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUSIONE

27. Referuar kërkesave të Vendimit 320/2020, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 233 datë 02.05.2024, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...} për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

28. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidatin znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati znj. {...}, e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 233 datë 02.05.2024.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 8 dhe në pikën 6, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, si dhe në pikën 10, të vendimit të tij nr. 233, datë 02.05.2024, “Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit znj. {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 233, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR